

## SIKUR SHQIPET NË FLUTURIM QË PUSHTOJNË HORIZONTE, PUSHTUAN SKENËN SHQIPET E ANSAMBLIT “ PAVARËSIA ”

*Për nder të 6 vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, të shtunën më 1 mars, u mbajt Mbrëmje familjare festive, e organizuar nga Shoqata “Pavarësia” në Stuttgart.*

*Përpos qindra mërgimtarëve që kishin ardhur të festojnë së bashku, këtë mbrëmje e madhështoi prezenca e ministrit të Diasporës, zotëri Ibrahim Makollit, konsullit të Republikës së Kosovës në Stuttgart, zotëri Faket Kajtazit, Shkollës shqipe “Gjuha Jonë” nga Fellbachu me mësuesen e nderuar, zonjën Shaha Bytyqi, çifti Nexhat dhe Remzije Pllana, ligjërues në Universitetin gjerman si dhe veprimtarë të ndryshëm të çështjes kombëtare.*



*Pas nderimit të Hymnit kombëtar dhe atij shtetëror, të pranishmit nderuan me një minutë heshtje edhe të rënë për liri, gjaku i të cilëve u bë themel i shtetit të Kosovës.*

*Si nikoqir i kësaj Mbrëmje, kryetari i Shoqatës “Pavarësia”, zotëri Baki Mustafa, përshëndeti të pranishmit dhe iu uroj ditëlindjen e gjashtë të shtetit të Kosovës, për t'i lënë hapësirë programit që kishin përgatitur për argëtimin e pjesmarrësve.*



*Nën duartrokitjet frenetike të mysafirëve dhe familjarëve, Ansambli “Pavarësia” prezantoi valle me motive të ndryshme, të përgatitura me mjeshtëri artistike nga koreografi Selajdin Shala, i cili nuk po kursen mundin dhe përkushtimin e tij, që të*

sjell për publikun një copë Atdhe këtu në mërgim,që edhe Rinia jonë përmes valles së bukur shqipe të ruaj traditën, kulturën dhe të krenohet me origjinën e saj.

Të përgatitur me shumë mjeshtëri dhe me një regji të shkëlqyeshme, koreografja e re dhe shumë punëtore , zonjusha Fatjona Mustafa, solli premierë në këtë mbrëmje “Vallen e gjeneratave”, e cila u prit shumë mirë nga të pranishmit.



- “ E ç’na duhen pasuritë e botës ,kur po i humbim fëmijët”, ishin këto vargjet që të rrëqethnin trupin, vargje nga një recital shumë domethënës, që kishte përgatitur mësuesja punëtore Shaha Bytyqi me nxënësit e saj. Ajo përcjellë mesazhin për domosdoshmërinë e vijimit të mësimit plotësues në gjuhën shqipe.

Për punën e palodhshme dhe kontributin e tyre ,kushtuar ruajtjes së vlerave kombëtare në mërgim, Ministria e Diasporës, nderoi me çmimin “Deklarata e Pavarësisë”, Shoqatën “Pavarësia” dhe Shkollën shqipe”Gjuha Jonë” , respektivisht kryetarin e shoqatës z. Baki Mustafa dhe mësuesen Shaha Bytyqi.





*Në këtë natë festive nuk mungoi as kënga e rapsodëve, me ç'rast rapsodi Shaban Çelaj kishte zgjedhur t'i këndojë takimit të heroit Isa Boletini me ministrin e Londrës.*

*Mbrëmjen e bëri më atraktive loja shpërblyese, e organizuar nga përfaqësuesi i Tring Digital, zotëri Faton Binakaj, që njëherit ishte edhe sponzor medial i kësaj Mbrëmje, ku fituesit fatlum iu dhurua një marrës satelitor Tring Digital, me abonim njëvjeçar.*

*Në vazhdim nën melodinë e bukur dhe zërin e ëmbël të këngëtarëve Sala Bekteshi dhe Nazmi Telaku, vazhduan vallet dhe atmosfera festive deri në mesnatë.*

